



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 27.05.2019, ora 10.30

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Raporti i veprimtarisë vjetore të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2018
2. Seancë dëgjimore me kandidatët për emërimin anëtar në Këshillin e Statistikave.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Reme Lala, Antoneta Dhima, Evis Kushi, Ervin Bushati, Vullnet Sinaj, Senida Mesi, Ismet Beqiraj, Nikolin Staka, Ardit Konomi, Edlira Hyseni, Artemis Dralo (Malo) dhe Dritan Bici.

Mungojnë:

Anastas Angjeli dhe Blerina Gjylameti.

Të ftuar:

Pajtim Melani - Kryetar i Bordit të AMF-së

Ervin Koçi - Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së

Lyela Rama – Drejtoreshë e Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve në AMF

Violanda Theodhori – Drejtoreshë e Departamentit të Çështjeve Juridike në AMF

Niko Kotonika – Drejtor i Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve dhe Kapitaleve në AMF

Adriana Ristani – Drejtoreshë e Departamentit të Zhvillimeve Strategjike dhe Operacionale në AMF

Edvin Peçi – Specialist i Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun dhe Medien në AMF

Eni Vasili – kandidate e propozuar nga Këshilli i Ministrave

Ines Mucostepa - kandidate e propozuar nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë

Endrit Lami - kandidate e propozuar nga Ministria e Financave

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Sot në rendin e ditës kemi raportin e veprimtarisë vjetore të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2018 dhe seancën dëgjimore me kandidatët për emërimin anëtar në Këshillin e Statistikave.

Të ftuar do të jenë zoti Endrit Lami, i propozuar nga Ministria e Financave, Ines Muçostefa e propozuar nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë dhe Eni Vasili e propozuar nga Këshilli i Ministrave.

Ndërkohë, për pikën e parë, raportin e veprimtarsisë, kemi të ftuar zotin Pajtim Melani, kryetar të Bordit, zotin Ervin Koçi, drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe stafi i tyre.

Fillojmë me relatorin.

Zonja Dhima, besoj se ju jeni gati. Dua t’i referoheni edhe rezolutës.

Do ta mbyllim ditën e sotme të gjithë procedurën me AMF-në. Dakord?

Faleminderit!

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Në bazë të raportit të paraqitur nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare vlerësohet puna dhe angazhimi i drejtuesve të këtij autoriteti, si dhe stafit përgjegjës. Mund të vlerësohet, në mënyrë të veçantë, veprimtaria e posaçme që ka bërë ky institucion gjatë vitit 2018 në kuadër të rritjes së transparencës me publikun dhe zbatimin e rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, i cili ka publikuar për herë të parë në faqen zyrtare të internetit të dhëna për të gjitha shoqëritë e sigurimit, për treguesit kryesorë të aftësisë paguese dhe njëkohësisht aktiviteteve të mbulimit të pulvigjioneve teknike.

Gjithashtu, Autoriteti, gjatë vitit 2018 i ka kushtuar vëmendje të veçantë monitorimit të përmbushjes në mënyrë efikase të detyrimit për informim nga shoqëritë që veprojnë në tregun e sigurimeve, duke ushtruar verifikime periodike dhe komunikim me shoqëritë e sigurimit për përmbushjen e detyrimeve për informacionin e detyrueshëm.

Po ashtu, rëndësi të veçantë gjatë vitit 2018 i është kushtuar dhënies së informacionit parakontraktual të konsumatorit që e njeh atë produkt, si dhe kushteve të sigurimit, me qëllim

verifikimin e sjelljes ndaj konsumatorit dhe marrjen e masave të nevojshme. Autoriteti ka kryer inspektime të vazhdueshme në subjekte të mbikëqyrura dhe në rastet kur është konstatuar mosdhënie e plotë e informacionit parakontraktual është vijuar me masa mbikëqyrëse përkatëse.

Në vijim, është ndjekur zbatimi i masave të autoritetit dhe ka rezultuar se ato janë përmbushur në një kohë shumë të shkurtër e pasuruar me tregues të rinj të buletinit statistikor të AMF-së për dëmet dhe fondin e kompensimit, duke e rritur më tej transparencën në tregun e sipërmarrjes.

Në funksion të mbrojtjes së investitorit Autoriteti publikon një sërë paralajmërimesh për rrezikun e disa produkteve financiare dhe aktivitetet e shoqërive të palicencuara në tregun e kapitaleve. Në këtë kuadër, Autoriteti ka kërkuar edhe mbështetjen e institucioneve përgjegjëse për ndërhyrjen e tyre në rastet e ushtrimit të aktivitetit të paligjshëm të këtyre subjekteve.

Bursa e parë shqiptare, e titujve ALSE, me kapital privat, e licencuar më 3.7.2017, e filloi zyrtarisht veprimtarinë e saj më 22 shkurt 2018. Sistemi i tregtimit të bursës është në funksion të mbrojtjes së interesave të investitorëve dhe sigurimit të një tregu të drejtë dhe transparent. Gjatë vitit të parë të aktivitetit të bursës Autoriteti ka miratuar edhe disa rregullore dhe dispozita nga Bursa Shqiptare e Titujve.

Në progresraportin e Bashkimit Europian për vitin 2018, kapitulli 9, “Shërbimet financiare”, theksohet se rregullat e BE-së synojnë sigurimin e konkurrencës së drejtë ndërmjet institucioneve financiare dhe stabilitetin e tyre, konkretisht në sektorin bankar, atë të sigurimeve, të pensioneve suplementare, shërbimet e investimit dhe tregjet e titujve. Ato përfshijnë rregulla për autorizimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e këtyre institucioneve. Theksohet se Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e shërbimeve financiare, janë bërë disa përparime në këtë fushë, ka pasur edhe disa përparime në mbikëqyrjen bankare dhe në përafrimin e mëtejshëm të informacionit me direktivën e solvenci 2.

AMF-ja gjatë vitit 2018 ka rritur inspektimet me tregjet e mbikëqyrura. Janë kryer 76 inspektime, kundrejt 22 të realizuara ...

Arben Ahmetaj – Më falni, do t’i lutesha medias të mos bëjë zhurmë, sepse po raportohet!

Antoneta Dhima – Janë realizuar 76 inspektime, kundrejt 22 inspektimeve të realizuara gjatë vitit 2017. Këto kanë qenë inspektime të plota me bazë rrezikun, inspektime tematike, inspektime në funksion të mbrojtjes së konsumatorit dhe inspektime për fondin e

kompensimit. Disa prej tyre janë realizuar në bashkëpunim edhe me institucione të tjera, siç janë Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave apo Banka e Shqipërisë.

Nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare rezulton se janë plotësuar të gjitha rekomandimet e dhëna nga Autoriteti i Konkurrencës, i cili thekson se brenda 90 ditëve duhet të realizohen disa masa të konstatuara nga Autoriteti.

Në tregun e sigurimeve ka pasur rezultate të ndjeshme dhe të dukshme krahasuar me vitin 2017 dhe njëkohësisht me vitin 2016.

Tregu i pensioneve vullnetare dhe fondeve të investimeve ka pasur tregues një rritje krahasuar me vitet 2016 dhe 2017.

Rezultatet e tregut të kapitaleve dhe provigjinoneve teknike ju i keni në materiale dhe në raportin që drejtori ekzekutiv i AMF-së ka paraqitur pranë Kuvendit.

AMF-ja ka dhënë rekomandime për përmirësim në rritje të treguesve të provigjionit teknik të dëmeve nga sigurimi i detyrueshëm në përputhje me rritjen e aktivitetit të tregut të sigurimeve. Këto rekomandime janë bazuar në analizat e të dhënave të shoqërive të sigurimeve, në gjetjet e konstatimit të inspektimeve në vend, si dhe nga informacioni i marrë nga palët e treta, që janë në rastin konkret gjykatat, për dëmet në procesin gjyqësor për detyrimet dhe rrezikun nga të cilat janë të ekspozuara shoqëritë.

Gjithashtu, mbikëqyrjet edhe analiza e rreziqeve të tregut, dhe ky është një element shumë i rëndësishëm i pasqyruar në raport.

Në fakt, nuk dua të ndalem në tregues të tjerë, pasi rezultatet e punës në këtë Autoritet janë të dukshme. Do të ndalem në projektrezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2018. Kuvendi i Shqipërisë, duke i konsideruar objektivat kryesorë të AMF-së për nxitjen dhe ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar dhe mbikëqyrjen e ligjshmërisë së veprimtarive të subjekteve të mbikëqyrura, veprimtari në funksion të rritjes së besimit të pjesëmarrësit të tregut financiar, mbrojtjen dhe informimin e konsumatorit në respektim të parimeve të transparencës, misionin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për krijimin e një tregu bashkëkohor dhe efektiv, që ofron shërbime cilësore dhe promovon zhvillimin e mëtejshëm të sektorit financiar jobankar në vend, ka marrë në shqyrtim veprimtarinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe vlerëson objektivat e AMF-së në drejtim të: hartimit të një plani konkret veprimi dhe punës për përkushtim drejt arritjes së misionit dhe synimeve strategjike si një autoritet mbikëqyrës me tregje financiare jobankare; sigurimin e realizimit të strategjisë dhe misionit në përputhje me standardet më të larta profesionale dhe me kosto racionale, zbatimin e standardeve më të larta etike në komunikimin dhe bashkëpunimin me grupet e interesit në procesin e mbikëqyrjes së tregjeve financiare

jobankare; publikimin sistematik të informacioneve për tregun, si dhe shërbimet për tregjet financiare jobankare të ofruara në Republikën e Shqipërisë; hartimin e një plani konkret dhe të posaçëm veprimi për mirëfunksionimin e Byrosë Shqiptare të Sigurimeve dhe problematikën e mbartur të Fondit të Kompensimit për sa i përket vlerës së miratuar të fondit të kompensimit dhe ecurisë së pagesave të kryera nga shoqëritë e sigurimit.

Kuvendi i Shqipërisë, duke e vlerësuar maksimalisht punën e bërë gjatë vitit 2018, kërkon që Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2019 të angazhohet në këto drejtime: të vijojë kontrolli i përmbylljes së pagesave të prapambetura të Fondit të Kompensimit dhe monitorimi i zbatimit të vendimit të bordit, me qëllim frenimin në të ardhmen të fenomeneve të akumulimit të borxheve dhe moskryerjen e pagesave brenda kufijve kohorë të ngjarjes së ndodhur, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë së Byrosë Shqiptare të Sigurimeve; të përdoren vlerësimet e rrezikut të nxjerra nga inspektimet e bëra në të kaluarën si bazë krahasimi midis shoqërive pjesëmarrëse të tregut të sigurimeve; çështjet e identifikuar si me rrezik më të lartë duhet të shërbejnë si orientim për t'u përqendruar në inspektimet e ardhshme; të analizohet niveli i rrezikut që paraqesin siguruesit dhe madhësia e tyre, në përputhje edhe me manualin e mbikëqyrjes dhe të vendosen prioritetet për alokimin e kapaciteteve mbikëqyrëse dhe për inspektime të mëtejshme; të bëhet ndjekja e rekomandimeve të lëna pas inspektimeve dhe sigurimi i korigjimit të tyre në periudhë të shkurtër kohore në përmbushje të dispozitave ligjore në fuqi, me qëllim mbrojtjen sa më të mirë të konsumatorit; tregjet që mbikëqyren nga AMF-ja duhet të fokusohen më shumë në drejtim të rritjes së besimit të konsumatorit dhe përmirësimit të shërbimit në tërësi. Në funksion të kësaj është i nevojshëm hartimi i një strategjie kombëtare për edukimin financiar të popullatës; të kryhen inspektime në vend pranë të gjitha subjekteve tregtare që ushtrojnë veprimtarinë si depozitarë të fondeve të pensionit dhe fondit të investimeve, me qëllim edhe verifikimin e procedurave të ndjekura për informimin e mjaftueshëm të depozitarëve për kontratën dhe marrëdhënien juridike në të cilën ata po investojnë; në kuadër të rritjes dhe forcimit të njohurive për tregjet nën mbikëqyrjen e AMF-së të standardizohen procedura të qarta dhe transparente monitorimi për shoqëritë që veprojnë në tregjet nën mbikëqyrjen për sa i përket sjelljes së tyre ndaj konsumatorit dhe organizimi i aktiviteteve me target moshat e reja, sidomos studentët; të punohet për thithjen dhe punësimin e specialistëve me ekspertë në fushën e financave dhe të rriten kapacitetet e stafit ekzistues; veprimtaritë jashtë vendit të kenë fokus përmirësimin e aftësive për menaxhimin e skenarëve të krizave të tregjeve nën mbikëqyrje dhe marrëveshjet dypalëshe që synojnë shkëmbimin e eksperiencave me trajnim në institucionet homologe; të fillojë puna për krijimin e një sistemi të ri raportimi për tregun e kapitaleve dhe pensioneve, që të bëjë të

mundur evidentimin *online* të brendshme dhe gjurmimin e tyre për ofrim sa më cilësor të shërbimit dhe ky mekanizëm të synojë të shtohet edhe në sistemin aktual të tregut të sigurimeve për sa u takon policave të sigurimit; të fillojë puna për hartimin e një dokumentimi fillestar, që të shërbejë si orientim dhe prezantim për hartimin e nismave ligjore në lidhje me zgjerimin e skemës së pensioneve private, rregullimin ligjor të mënyrës së organizimit të kolonës së dytë të pensioneve private. Materialet të paraqiten pa u kufizuar në analizën e plotë të risqeve dhe anën pozitive për sa u takon kapaciteteve financiare që AMF-ja beson që janë ende të lira dhe që parashikohet se do të angazhohen në skemat e pensioneve private.

E fundit, të evidentohen problematikat e deritanishme dhe të analizohen perspektivat 5-vjeçare e tregut të titujve, duke përfshirë përbërjen e projeksioneve mbi këtë treg dhe analizën e plotë të risqeve, si dhe anët pozitive për sa i përket kapaciteteve financiare që AMF-ja beson se mund të parashikohen se do të angazhohen në tregun e titujve.

Faleminderit, zoti kryetar!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Dhima!

Antoneta Dhima – Zoti kryetar, kisha dy pyetje.

Arben Ahmetaj – Nuk kemi arritur akoma te pyetjet.

Ju falënderoj edhe për leximin e draft-rezolutës, që përmbledh të gjitha problematikat. Pikë së pari, ajo vlerëson punën e AMF-së, të drejtorit dhe të kryetarit dhe, nga raporti i dorëzuar në komision, flas për raportin ndihmës, duket qartë një përmirësim i vazhdueshëm i punës ndër vite. Ndërkohë, komisioni do të vazhdojë të monitorojë punën tuaj në bazë të referencës së ligjit, do të zhvillojmë takime edhe më të shpeshta në vazhdimësi, në mënyrë që problematikat kryesore, sidomos ato të jetës, të pensioneve vullnetare dhe të tregut të kapitaleve, të ecin pak më shpejt. Patjetër që në raport vihet re qartë se ka një problematikë në lidhje me legjislacionin që nuk ju takon juve, si autoritet, por ligjvënësit, megjithatë edhe këto janë elemente që ne i kemi reflektuar në rezolutë.

Fjalën e ka zoti Koçi.

Si e keni ndarë?

Pse duhet ta bëjnë raportin kryetari dhe drejtori?

Ervin Koçi – Kështu ka qenë si praktikë, por gjithsesi vendosni ju zoti kryetar.

Arben Ahmetaj - Hidheni në short, sepse njëri nga ju do ta bëjë!

Ervin Koçi – I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, për transparencë dhe llogaridhënie AMF-ja ju ka paraqitur raportin vjetor dhe pasqyrat financiare që e shoqërojnë atë për vitin 2018.

Prezantimi i zhvillimeve kryesore gjatë këtij viti do t'ju japë një pasqyrë të qartë të punës sonë, të sfidave dhe të problematikave me të cilat jemi përballur. Aktiviteti i AMF-së është mbështetur në tre shtylla kryesore: në zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullativ, në objektivat e përcaktuara në strategjinë 5-vjeçare të autoritetit, si dhe në rekomandimet e dhëna nga Kuvendi i Shqipërisë në rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së autoritetit për vitin 2017”.

Në fillim të vitit ne hartuam një plan të detajuar veprimi, në funksion të prioritetëve të përcaktuara, si sfidat e zhvillimit afatmesëm. Prioritetet kryesore për vitin 2018, ku është mbështetur puna jonë, kanë qenë:

- mbrojtja e konsumatorit në tregun e sigurimeve dhe investitorët në tregun e kapitaleve, si dhe edukimi financiar i publikut;
- zhvillimi i tregjeve financiare dhe rritja e gamës së produkteve financiare në funksion të rritjes ekonomike të vendit;
- përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetit të mbikëqyrjes edhe nëpërmjet rritjes së kapaciteteve profesionale;
- forcimin e rolit mbikëqyrës për të pasur tregje të shëndetshme dhe moskërcënimin nga risqet sistemike;
- inovacionet teknologjike dhe rritja e transparencës, ka qenë një prioritet i yni
- hartimi dhe miratimi i kuadrit ligjor dhe rregullativ, i harmonizuar me direktivat e BE-së;
- forcimi i bashkëpunimit me institucionet brenda dhe jashtë vendit.

AMF-ja ka qenë i përkushtuar për të zbatuar me përpikëri planin e veprimit për vitin 2018 për të përmbushur objektivat e përcaktuara në strategjinë 5-vjeçare (janar 2018 – dhjetor 2022). Ne synojmë që implementimi i strategjisë, të nxisë zhvillimin e tregjeve financiare konkurruese dhe eficiente, duke krijuar njëkohësisht stabilitet afatgjatë dhe duke i dhënë mundësi krijimit të produkteve inovative, si dhe duke rritur besimin dhe mbrojtur konsumatorin dhe investitorin. Gjatë vitit 2018 fokusi kryesor në aktivitetin e Autoritetit ka qenë mbrojtja e konsumatorëve dhe investitorëve nëpërmjet:

- trajtimit të shpejtë dhe efikas të ankesave ndaj subjekteve nën mbikëqyrje;
- njoftimeve paralajmëruese për publikun;
- rritjes së nivelit të edukimit financiar dhe rritjes së transparencës;
- monitorimit të zbatimit të legjislacionit në fuqi dhe forcimit të veprimeve parandaluese në sjelljen e tregjeve dhe subjekteve nën mbikëqyrje;
- përmirësimit të kuadrit ligjor dhe rregullativ;

- bashkëpunimit me institucionet e tjera.

Në shërbim të transparencës dhe krijimit të lehtësive për konsumatorin u krijua platforma e raportimit të ankesave *online* për tregjet nën mbikëqyrje, ku çdo konsumator mund të depozitojë një ankesë *online* duke plotësuar një formular të gatshëm dhe të ndjekë në kohë reale fazat e shqyrtimit të saj, si edhe përgjigjen përkatëse. Një vëmendje e veçantë u është kushtuar fushatave për rritjen e edukimit financiar të publikut në zbatim të strategjisë 3-vjeçare “Për rritjen e besimit të konsumatorit e investitorit në tregjet nën mbikëqyrje (tetor 2017–tetor 2020)”. Ndër aktivitetet më të rëndësishme do të përmendja:

- organizimin e Konferencës së parë Kombëtare “Edukimi financiar” në bashkëpunim me universitetet dhe studentët, ndërsa këto ditë zhvilluam konferencën e dytë;

- leksione të hapura të zhvilluara në universitete, të cilat janë finalizuar me nënshkrimin e 7 marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitetet;

- rritja e prezencës në media dhe qenia më aktiv në rrjetet sociale

Ne kemi bashkëpunuar me subjektet nën mbikëqyrje për kryerjen e praktikave mësimore të 300 studentëve për vitin 2019, ku, deri tani, rreth 130 studentë i kanë kryer praktikat mësimore.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni tani të ndalem në zhvillimet kryesore të Autoritetit dhe tregjet nën mbikëqyrje gjatë vitit 2018, duke ju informuar edhe mbi zbatimin e rezolutës së Kuvendit.

Po e filloj me Fondin e Kompensimit, për shkak të ndjeshmërisë së madhe publike që ka për këtë çështje, por edhe për faktin se 4 pikat e rezolutës kishin të bënin pikërisht me këtë problematikë.

Për mua, si drejtues i institucionit, është kënaqësi të ndaj me ju një nga arritjet më të rëndësishme të realizuara nga Autoriteti përgjatë viteve të fundit,

zgjidhje e problematikës së Fondit të Kompensimit mbartur nga viti 2002 dhe akumuluar vit pas viti.

Autoriteti zbatoi një plan konkret dhe të posaçëm veprimi lidhur me mirëfunksionimin e Byrosë Shqiptare të Sigurimit dhe problematikën e mbartur të Fondit të Kompensimit. Pas inspektimeve të kryera bordi i Autoritetit ka miratuar dy shtesa të Fondit të Kompensimit për vitin 2018, si dhe mori masa ndaj shoqërive për rastet e moszbatimit të vendimeve të autoritetit. Pagesat për Fondin e Kompensimit, vetëm për vitin 2018 janë në vlerën mbi 1 miliardë lekë, si dhe u skeduluan për pagesë rreth 204 milion lekë, vlerë e cila është pothuajse sa për 3 vite të marra së bashku 2014-2015-2016. Pagesat për vitin 2018 kanë qenë 39% më shumë se viti

2017 dhe pothuajse dy herë më shumë se viti 2016. Me qëllim miradministrimin e Byrosë janë ndërmarrë veprime si miratimi i drejtorit të ri, ndryshime në aktet rregullative dhe miratimi i disa rregulloreve nga ana e Byrosë. Për nxjerrjen e saktë të raporteve të dëmeve, objekt i Fondit të Kompensimit, që prej janarit 2019, funksionon pranë Byrosë “Sistemi elektronik i administrimit të dëmeve”. Në forcimin e rolit mbikëqyrës të autoritetit jemi përqendruar në shëndetshmërinë e tregjeve dhe subjekteve nën mbikëqyrje, rritjen e cilësisë së shërbimit, performancës dhe përmirësimin e qeverisjes kooperative të subjekteve nën mbikëqyrje, si dhe marrjen e masave administrative e korigjuese.

Gjatë vitit 2018 në forcimin e rolit mbikëqyrës kanë dhënë ndikim:

- përmirësimi cilësor i analizave financiare (inspektimet *off-site*) bazuar mbi raportimet periodike 3-mujore dhe vjetore të shoqërive në mbikëqyrje;
- rritja e cilësisë dhe inspektimeve në vend (inspektimet *on-site*);
- miratimi i rregulloreve të reja dhe përmirësimi i atyre ekzistuese.

Për herë të parë në faqen zyrtare *online* të autoritetit, në seksionin “Publikime” në muajin shtator 2018, u publikuan të dhënat e certifikuara dhe të thjeshtuara për të gjitha shoqëritë e sigurimit, ku, ndër to, përfshihet aftësia paguese dhe aktivet në mbulim të provigjoneve teknike, një rekomandim ky edhe i rezolutës së Kuvendit.

Një faktor tejet i rëndësishëm ishte dhe rritja e numrit të inspektimeve gjatë vitit 2018 për tregjet e mbikëqyrura, duke realizuar 76 inspektime, kundrejt 22 të realizuara gjatë vitit 2017. Disa prej tyre janë realizuar edhe në bashkëpunim me institucione të tjera si Drejtorinë e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, Bankën e Shqipërisë dhe Policinë e Shtetit. Viti 2018...

Arben Ahmetaj – Zoti drejtor, besoj se nuk do të lexoni të gjithë raportin, sepse e kemi përpara! Kapuni pas kapitujve kryesorë, theksoni problematikat kryesore, pasi duhet t’u japim kohë deputetëve që të bëjnë pyetje dhe komente.

Ervin Koçi - Faleminderit, zoti kryetar!

Po e thjeshtoj.

Tregu i sigurimeve gjatë vitit 2018, ka vijuar prirjen e tij për zgjerim. Primet e shkruara bruto kanë shkuar në rreth 17,93 miliardë lekë, ose 5% më shumë se në vitin 2017. Totali i dëmeve të paguara bruto, në vitin 2018, arriti në 7,98 miliardë lekë, 26% më shumë se në vitin 2017 dhe 47% më shumë se viti 2016. Raporti dëme/prime, arriti shifrën 42%, i krahasueshëm tashmë me vendet e rajonit. Gjatë vitit 2018 janë paguar 1,44 miliardë lekë dëme

më shumë se viti 2017 kur primet për këtë periudhë janë rritur vetëm me 0,8 miliardë lekë, që tregon që shoqëritë e sigurimit po rrisin performancën dhe cilësinë e qeverisjes korporative.

Procedura e trajtimit të dëmit dhe cilësia e shërbimit janë sfidat e këtij viti për këtë treg dhe jemi në fazën përfundimtare të implementimit të regjistrimit *online* të dëmeve, financiar nga shoqëritë e sigurimit, ku autoriteti do të monitorojë *online* procesin e trajtimit të dëmeve dhe çdo qytetar përfitues do të ketë mundësi të ndjekë në kohë reale çdo hap të procesit të trajtimit të dëmit. Në tregun e sigurimeve, numri i kontratave vijoi rritjen me 6% krahasuar me një vit më parë dhe pesha specifike e volumit të tregut të sigurimeve në raport me prodhimin e brendshëm bruto rezulton 1,06%, me një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2017.

Tregu i fondeve të investimeve pësoi një tkurrje prej 6,6% krahasuar me një vit më parë. Arsyet e tkurrjes mendohet të kenë ardhur si rezultat i kthimeve të ulëta nga investimi, veçanërisht në valutë të huaj, si edhe nga efekti i kursit të këmbimit. Vlen të theksohet se tregu i fondeve të investimeve u zgjerua me dy fonde të reja investimi, si dhe u licencua një shoqëri të re administruese. Risia në tregun e kapitaleve, për vitin 2018 ishte fillimi zyrtarisht i veprimtarisë së Bursës së parë Shqiptare të Titujve, ALSE. Sistemi i tregtimit të Bursës monitorohet nga Autoriteti në kohë reale, në funksion të mbrojtjes së interesave të investitorëve dhe sigurimit të një tregu të drejtë dhe transparent. Gjatë vitit të parë të aktivitetit të saj vlera totale e tregtimit në Bursë arriti në nivelin rreth 1.4 miliardë lekë, ku kanë dominuar transaksionet me bono thesari.

Tregu i fondeve të pensionit vullnetar ka vijuar prirjen për zgjerim. Totali i aseteve neto të këtij tregu për vitin 2018 ishte 2,3 miliardë lekë me rreth 25,300 anëtarë. Asetet neto u rritën me 33%, ndërsa numri i anëtarëve me 21% krahasuar me vitin 2017.

Për sa i përket përmirësimit të kuadrit rregullator të tregjeve nën mbikëqyrje, në vitin 2018, Autoriteti finalizoi hartimin e projektligjit “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, të cilin e kemi depozituar pranë Kuvendit dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti drejtor, se do të filloj edhe unë të them shifrat që siguri vullnetar me 25 mijë e 300 është rritur me 27%, folëm për thekset.

Ju falënderoj për raportimin tuaj!

(Ndërhyrje pa mikrofoni)

Besoje se mbledhjen e drejtoj unë. A do të ma bëni mua pyetjen apo drejtorit? Raportin e keni përpara, apo jo?

A ka pyetje apo komente?

Le ta fillojmë me relatorin!

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti drejtor, për prezantimin! Unë kam dy pyetje. Në fjalën tuaj dhe në raport, duket qartë që është punuar në lidhje me rregulloret më bazën ligjore, si dhe ka pasur zhvillime të reja në tregun e kapitaleve, e vlerësuar kjo edhe nga ana e FMN-së.

Si e sheh AMF-ja zhvillimin e ardhshëm të Bursës Shqiptare të Titujve dhe çfarë është bërë nga ana juaj në lidhje me përmirësimin e infrastrukturës së këtij lloji tregu?

E dyta, sipas raportit që kemi, tregu i investimeve ka pasur tkurrje krahasuar me vitin 2017 dhe ka pasur rritje krahasuar me vitin 2016.

Cilat janë arsyet që në vitin 2018 ka pasur tkurrje në krahasim me vitin 2017?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Më fal, por e thotë raporti, është kryesisht kursi i këmbimit, megjithatë pyetja është e drejtë.

Ervin Koçi – Faleminderit zoti kryetar, faleminderit dhe ju, zonja deputete!

Në lidhje me pyetjen për Bursën, në opinionin tim, por edhe të autoritetit të bordit, Bursa është një strukturë shumë e rëndësishme në tregun e kapitaleve, që ka ndikim jo vetëm për sa i përket çlirimit të energjive pozitive në ekonomi, por edhe për zhvillimin ekonomik të vendit. Faktikisht ne e kemi pasur me shumë prioritet bursën dhe monitorimin e saj dhe në muajin shkurt të këtij viti, ne kemi dhënë licencë për tregtimin për aksione e obligacione private në bursë. Tashmë ajo është duke operuar dhe po pret të marrë një licencë edhe nga BSH-ja. Gjithsesi, duke i qëndruar pyetjes suaj se si e shohim Bursën në të ardhmen, po ju them që e shoh shumë të rëndësishme. Po të shohim sot në raportin që kemi, huanë, depozita është në raportin 50%, pra 50% e parave shqiptare sot flenë gjumë, nuk injektohen në ekonomi, tek biznesi, tek individët, apo në projekte për të financuar investime që i shërbejnë punësimit dhe rritjes ekonomike. Në rast se ne do ta ndjekim me kujdes, me një mbikëqyrje prudente, si dhe duke bashkëpunuar me të gjithë aktorët, tregun qeverinë, unë jam i sigurt që sikur 10% e këtyre parave t'i kanalizojmë në Bursë, do të krijojmë energji pozitive, që mund të ndikojnë në rritjen ekonomike minimalisht 1%. Është shumë i rëndësishëm dhe funksionimi i bursës. Ne, si Autoritet, kemi kontaktuar edhe me aksionerët, të cilëve u kemi kërkuar të krijojnë jo vetëm besueshmëri në treg, por të shikojnë edhe angazhimin e partnerëve të huaj, në mënyrë që të kemi metoda bashkëkohore për zhvillimin dhe monitorimin.

Arben Ahmetaj – Zoti Koçi, për sa i përket tregut të kapitaleve, ju e theksuat rëndësinë e tij të veçantë. Ndërkohë, pjesa më e madhe janë tituj qeveritarë dhe këtë e them në mënyrë modeste. Besoj se puna e gjatë rreth 3 apo 4-vjeçare për ta krijuar, dhe më pas, nëpërmjet jush, për të dhënë një licencë për një platformë tregtimi, si ajo që ju referuam pak

më sipër, patjetër që është arritje. Tani, sfida duhet të jetë, duke filluar që nga procedura dhe rregulloret, deri tek tërheqja në tregun e kapitaleve të kompanive shqiptare. Ndoshta ka ardhur koha që ju, së bashku me ne dhe qeverinë, të shikojmë mundësinë e hartimit të kësaj platforme, duke iu referuar platformave më prestigjioze ndërkombëtare, duke filluar modesisht nga Milano, Frankfurti, deri te platforma globale, dhe në referencë të tregut të aksioneve. Kjo kuptohet që është një sfidë e madhe për të arritur një ditë deri në Londër apo Nju Jork, me titujt e kompanive të ndryshme globale.

Ervin Koçi – Kjo është e vërtetë, zoti kryetar!

Ky duhet të jetë misioni ynë i përbashkët për të ardhmen e zhvillimit të bursës, por, aktualisht, ne kemi përmirësuar disa rregullore që janë vlerësuar shumë edhe nga FMN-ja, e cila bëri një progres rrënjësor për Autoritetin në hartimin e rregulloreve dhe monitorimin e tregut të kapitaleve. E rëndësishme është se para një muaji ne kemi dërguar dy ligje të reja në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të cilat kanë të bëjnë me rregullimin e kësaj gjëje, si dhe me idenë tuaj për të pasur edhe një depozitë qendrore, në mënyrë që klerimi të bëhet transparent, i thjeshtë dhe me kosto të ulët për publikun dhe biznesin. Unë jam shumë i bindur që, nëse ne të gjithë së bashku i bashkojmë energjitë, siç e përmendët edhe ju, do të kemi tregues pozitiv në ekonominë shqiptare për sa i përket funksionimit të bursës.

Për sa i përket pyetjes së dytë lidhur me tkurrjen në tregun e investimeve për vitin 2017, kjo përmendet pak edhe në raport, por gjithsesi kanë qenë dy.

E para, po të shikojmë Bankën e Shqipërisë në vite, ka mbajtur norma të ulëta interesi në bazë dhe norma e kthimit është e ulët. Normalisht, kur individët kanë normë të ulët kthimi dhe kur të gjitha investimet, siç e tha kryetari, janë obligacione dhe bonde qeveritare, është normale që qytetarët do të shikojnë një alternativë tjetër investimi.

E dyta është edhe kursi i këmbimit. Ne kemi një fond investimesh, që operon edhe në monedhën euro dhe të gjitha këto kanë ndikuar në këtë aspekt. Gjithsesi, duhet theksuar që ne kemi bërë edhe një simulim bashkë me Bankën Botërore, Fondin Monetar Ndërkombëtar, Ministrinë e Financave, Bankën e Shqipërisë, ku ka rezultuar se tregu i kapitaleve është një treg shumë i shëndoshë. Të gjitha këto institucione u përgjigjën në mënyrën e duhur për të përballuar, në rast se do të kemi, ndonjë krizë.

Kjo tregon se sa e rëndësishme për ne është që të kemi siguri në këto tregje dhe të krijojmë besim te qytetarët, njëkohësisht, edhe t'i administrojmë në mënyrën e duhur që nesër këto të kthehen në benefite për ekonominë e vendit dhe për ekonomitë familjare të qytetarëve.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera?

Po, zonja Kushi.

Evis Kushi – E falënderoj drejtorin për prezantimin e raportit, por edhe për punë e bërë në krye të këtij institucioni!

Unë kam dy pyetje, të cilat lidhen me raportin e veprimtarisë së këtij institucioni për vitin 2018, por edhe me punën tuaj në vazhdimësi.

Së pari, të gjithë e dimë se fondi i kompensimit ka qenë një ndër problemet më shqetësuese të institucionit, por edhe të tregut të sigurimit financiar. Një nga problemet më shqetësuese ndër vite, e cila gjithmonë ka qenë pikë e rezolutës, por ju e përmendët në raport gjatë prezantimit tuaj, është që Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka ndërmarrë një sërë vendimesh për zgjidhjen e këtyre problemeve. Shifra prej 1 miliard lekësh në vitin 2018 flet qartë se ka një përmirësim të ndjeshëm, por problemi ende ekziston dhe është shqetësues. Prandaj, unë do të doja të dija se çfarë veprimesh të tjera parashikoni për vitin 2019 dhe në vazhdimësi? A do të ketë ndonjëherë zgjidhje ky problem?

Së dyti,...

Arben Ahmetaj – Më falni, zonja Kushi, por ky problem është drejt zgjidhjes!

Evis Kushi – Ju lutem, mos m'i komentoni pyetjet!

Arben Ahmetaj – Por ju e parashtroni si problem.

Evis Kushi – Unë po i bëj një pyetje drejtorit dhe le të përgjigjet ai.

Arben Ahmetaj – Patjetër, por...

Evis Kushi – Sepse ky problem qëndron, ka përmirësim të ndjeshëm, por, ama, nuk është zgjidhur përfundimisht. Atëherë, unë dua të di perspektivën.

Arben Ahmetaj – Ky problem nuk është shqetësim, sepse është në përmirësim. Ju i keni parë shifrat në raport, apo jo?

Evis Kushi – Unë e përmenda se shifra 1 miliard lekë flet qartë që në vitin 2018 ka përmirësime, por ende ka probleme. Unë për këtë dua ta pyes drejtorin: si e parashikon ai perspektivën? A është drejt zgjidhjes përfundimtare ky problem, apo do të marrë më shumë kohë për t'u zgjidhur?

E dyta, ka lidhje me edukimin financiar. Edhe kjo ka qenë gjithmonë pikë e rezolutës dhe më vjen mirë që, para pak ditësh, ju keni zhvilluar konferencën e dytë pikërisht për këtë qëllim, për edukimin financiar. Kjo iniciativë duhet përshëndetur, sepse duket qartë që po e ktheni në traditë. Gjithashtu, gjatë fjalës suaj dëgjova se keni ndërmarrë edhe veprime të tjerë, për shembull, për marrëveshjet me universitetet apo edhe prezenca e shtuar në medie e institucionit për këtë objektiv. Unë dua të di se çfarë hapash të tjera do të ndërmerrni? A e keni *feedback*-un për këto aktivitete që ju kemi ndërmarrë? A kanë dhënë ndonjë rezultat? Pra, a

keni marrë ju një *feedback* dhe si është pritur kjo veprimtari e shtuar në lidhje me plotësimin këtij objekti?

Edhe njëherë ju përgëzoj për punën dhe ju uroj suksese!

Faleminderit!

Ervin Koçi – Faleminderit, zonja deputete!

Faktikisht, fondi i kompensimit ka qenë një problematikë e akumuluar prej vitit 2002 dhe çdo vit është shtuar, duke mos i dhënë zgjidhje. Sot ne i kemi dhënë zgjidhje përfundimtare dhe nuk mund të themi se kemi probleme me fondin e kompensimit. I vetmi problem që kemi sot, është se harxhojmë shumë energji, pasi ne bëjmë edhe punën e byrosë. Normalisht, në ligjin e ri që kemi sjellë, i cili shpresoj që të miratohet së shpejti, e kemi ndarë byronë në dy pjesë. Unë këmbëngula që byroja të ndahej në dy pjesë dhe të administrohej nga Autoriteti, në mënyrë që të mos harxhojmë energji dhe të jemi sa më racionalë në kapacitetet tona. Gjithsesi, ne kemi ndjekur me vëmendje dhe kemi bërë inspektime, siç bëmë vjet një planveprimi të posaçëm dhe këtë e kemi edhe këtë vit. Ne përgatitim një planveprimi të posaçëm çdo 3 muaj dhe kryejmë inspektime në çdo shoqëri dhe në çdo byro për të parë ecurinë e pagesave, njëkohësisht, edhe ndonjë zvarritje që mund të bëhet nga shoqëritë e sigurimit. Për 3-mujorin e parë shifra e paguar ishte rreth 200 milionë lekë të reja nga i gjithë tregu i sigurimeve. Kjo tregon se tashmë edhe kompanitë e kanë kuptuar se kjo është një përgjegjësi e tyre dhe që pagesa e dëmeve rrit edhe besimin në treg. Besoj se aktualisht më e rëndësishme për mua, për ju, për Autoritetin, për tregun dhe për qytetarët është të miratojmë sa më shpejt ligjin e ri.

Për sa i përket edukimit financiar, unë faktikisht sa e mora këtë detyrë, bashkë me bordin e Autoritetit, miratuam strategjinë për rritjen e besimit dhe edukimit financiar. Besoj se jemi i vetmi institucion, pa modesti, që kemi bërë një punë të jashtëzakonshme me të gjitha universitetet, me studentët dhe me tregun. Njëkohësisht, ne kemi bërë shumë aktivitete me shoqata të ndryshme, në mënyrë që të rrisim nivelin e edukimit financiar.

Shqipëria është një vend, i cili nivelin e edukimit financiar e ka shumë të ulët, rreth 14%, duke futur edhe sektorin bankar. Unë besoj se është më i ulëti në rajon.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rajon mesatarja është rreth 28 apo 30%, ndërsa BE-ja e ka mbi 50%.

Ky është një vërtetim që ka bërë *Standard and Poor's* në vitin 2014 dhe nuk ka studime të tjera. Ne kemi bërë vërtetime, por nuk kanë qenë profesionale.

Gjithsesi e rëndësishme është se ne do të kemi një strategji kombëtare për sa i përket dukurisë financiare, ku do të përfshihet Ministria e Arsimit, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencia e Sigurimit

të Depozitave. Ky është një plan konkret, ku në shumë vende po e aplikojnë, sepse ka qenë shumë i suksesshëm dhe për shkak të zhvillimeve teknologjike, të cilat janë shumë të rëndësishme për publikun.

Ne u kemi dërguar një shkresë, përpara disa javësh, të gjithë ministrive dhe Bankës së Shqipërisë për të bashkëpunuar për hartimin e një strategjie kombëtare.

Në muajin tetor të vitit të kaluar kemi bërë një marrëveshje me universitetet për të trajnuar 300 studentë në tregjet e mbikëqyrjes dhe në Autoritet. Fakti që janë futur në trajnim 130 studentë tregon se ne e kemi prioritet. Gjithashtu, ne bëjmë leksione të hapura për studentët.

Unë mendoj se edukimi financiar është baza për të pasur tregje të zhvilluara të sigurt, të besueshme për të bërë investime të zgjuara.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera? Po, Senida.

Senida Mesi – Përshëndetje të gjithëve!

Ju falënderoj për prezantimin!

Komenti që i bëra kryetarit, është se nga ju dua të di për risitë që ka sjellë AMF-ja nën drejtimin tuaj.

Është shumë e rëndësishme që drejtuesi i këtij institucionit, në kuadër edhe të problematikave dhe specifikave që ka AMF-ja, si një nga institucionet shumë të rëndësishme në dy këndvështrime, në ruajtjen dhe sigurinë e tregut monetar dhe financiar, të krijojë garancinë për konsumatorin, i cili duhet të ketë informacionin e duhur për të marrë vendimet e duhura, ku dhe si duhet të sigurohet dhe sigurisht që çdo dëmtim do t'i paguhet. Në rastin konkret pyetja ime është: cilat janë ato risi që ju i quani më të suksesshme gjatë menaxhimit tuaj si drejtor ekzekutiv i AMF-së?

Pyetja e dytë, cilat janë veprimet konkrete që janë ndërmarrë nga AMF-ja për mbrojtjen e konsumatorit? Kjo pyetje është më shumë për konsumatorin se sa për anëtarët e komisionit, të cilët e kanë raportin përpara.

Në lidhje me përafrimin e legjislacionit dhe në kuadër të direktivave të Bashkimit Europian, por edhe për përmirësimin e kuadrit ligjor, me aq sa kemi lexuar në raport, janë bërë katër projektligje, të cilat janë konsultuar me grupet e interesit, por edhe me konsumatorin, të ndihmuar edhe nga ndërkombëtarët. Në kuadër të rolit të monitorimit dhe kontrollit që ushtron Kuvendi i Shqipërisë ndaj institucioneve të pavarura, ne duhet të shikojmë dhe rezultatet, por asnjëri nga këto projektligje nuk ka ardhur në Kuvendin e Shqipërisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, shënoni pyetjet pastaj do të diskutojmë. Ndoshta problemi nuk është 100% tek AMF-ja, pasi ju i keni dorëzuar projektligjet dhe i keni konsultuar me publikun, po dua të kuptoj se ku kanë ngecur dhe Komisioni i Ekonomisë dhe Financave, nga ana tjetër, të ushtrojë funksionet e tij monitoruese dhe kontrolluese të institucionit ku kanë ngelur këto projektligje. Pra, duhet të dimë se ku ka ngelur këto projektligje, sepse njëri nga projektligjet është propozuar që në vitin 2015 dhe sot jemi në vitin 2019, ndërsa projektligji “Për sigurimin e mjeteve motorike në transport” ishte i ri dhe ka ardhur në mesin e vitit të kaluar, prandaj jemi në limitet kohore për ta kaluar në Kuvend.

Pyetja e tretë është në lidhje me tregun e sigurimeve. Duke parë shifrat dhe raportet, shihet një përmirësim i dukshëm i performancës i raportit dëm – prim, që është shumë i rëndësishëm, por më i rëndësishëm është raporti pagesa – dëme. Si ka evoluar raporti pagesa – dëme?

Në kuadër të regjistrimit elektronik dhe të sigurimit të detyrueshëm (tani po flas si konsumator dhe si qytetar), a do të kemi një regjistër elektronik ku të shikojmë në varësi të të gjitha institucioneve dhe agjencive të sigurimit një listë me informacion që mund të hapet, pa prishur dhe pa cenuar konkurrencën, me qëllim që të shikojmë raportet në kohë reale të dëmeve të shkaktuara, pagesat e këtyre dëmeve, kohën e pagesës së këtyre dëmeve dhe ajo që është shumë e rëndësishme sa është detyrimi total ndaj palëve të treta që ka i gjithë sistemi? Unë mendoj se kjo duhet të jetë edhe një nga prioritetet e vitit 2019 për AMF-në.

Pyetja e katërt lidhet me pjesën e raportit Manival. Shqipëria, sikurse e dini, edhe në kuadër të integritetit të Bashkimit Europian monitorohet nga shumë institucione dhe në një nga raportet që doli vitin e kaluar ishte se Shqipëria kishte përmirësim, por dolën dhe një sërë rekomandimesh, të cilat janë shumë të rëndësishme për t’u ndjekur. Pyetja ime për ju si drejtor ekzekutiv i AMF-së është: sa nga këto rekomandime po ndjek AMF-ja dhe çfarë hapash konkretë duhet të ndërmerreni ju, qeveria shqiptare dhe Kuvendi i Shqipërisë, me qëllim që në raportin e ardhshëm të Manival Shqipëria të përmirësohet ndjeshëm?

Pyetja e fundit ka të bëjë me një element financiar në lidhje me kompanitë shqiptare të sigurimit. A i kemi të mbuluara të gjitha kompanitë me kapital, sipas detyrimeve ligjore për mbulim të provigjoneve? A ka kompani në Shqipëri që nuk i plotëson këto kushte dhe çfarë ka bërë AMF-ja në lidhje me plotësimin e këtij detyrimi shumë të rëndësishëm ligjor?

Po përmend një shembull, së fundi u mbyll dega në Kosovë e INSIG-ut për mosmbulim të këtij kapitali. Unë dua të kuptoj nëse ka kompani të tjera në Shqipëri që nuk plotësojnë një detyrim të tillë ligjor. Cili është risku për tregun e sigurimeve në Shqipëri dhe çfarë masash po ndërmerr AMF-ja në lidhje me minimizimin e këtij risku?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Po, drejtor.

Ervin Koçi – Faleminderit, zoti kryetar!

Për sa u përket risive që kanë ardhur në Autoritet me drejtimin tim, bashkë me stafin kemi shumë arritje pozitive dhe ka pasur shumë risi.

Edukimi financiar, të cilin e shpjegova, e kemi futur në prioritet dhe e quajmë shumë të rëndësishëm për zhvillimin e tregjeve.

Njëkohësisht ne po zgjidhim të gjitha problemet e akumuluar. Ne nuk kemi pasur problem vetëm fondin e kompensimit të akomoduar, por kemi pasur edhe probleme të trashëguara ndër vite, të cilat përbënin një pengesë për zhvillimin e tregut dhe për besueshmërinë e konsumatorit.

Arritje tjetër e rëndësishme ka qenë rritja e rolit mbikëqyrës, siç e shikoni. Inspektimet e kryera nuk kanë qenë thjesht për numër, por kanë qenë shumë profesionale dhe tematike, të cilat janë bërë në bashkëpunim me Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parave, që është pika e fundit, me Bankën e Shqipërisë, me autoritete të huaja, kemi pasur edhe me Policinë e Shtetit, ku kemi bërë edhe inspektime të përbashkëta për të mbrojtur qytetarët nga policat false ose që nuk mund të deklaroheshin në regjistrin elektronik të Autoritetit.

Një tjetër risi ka qenë kuadri rregullator, të cilin do ta shpjegoj në pjesën e dytë.

Ne kemi bërë një punë të jashtëzakonshme, por një risi që është shumë e rëndësishme ka të bëjë me rregulloren nr. 53, të cilën e kemi ndryshuar vitin e kaluar. Duke filluar nga 1 qershori i vitit të kaluar, çdo qytetar në Republikën e Shqipërisë, i cili është përfitues i dëmit shëndetësor përfiton më shumë se 38%. Kur kam shkuar atje, tabelat e anulitetit ishin të vitit...

Arben Ahmetaj – Më fal, ku shkuat, sepse iu referuat “kur shkova atje”?

Ervin Koçi – Në drejtim të Autoritetit.

Arben Ahmetaj – E kishit fjalën kur morët detyrën?

Ervin Koçi – Po, më falni, kryetar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Autoriteti përdorte tabelat e anulitetit, të cilat ishin të vitit 1922 të shtetit italian. Pastaj ne bëmë marrëveshje me INSTAT-in dhe e vendosëm në funksionim. Sot qytetarët që kanë një dëm shëndetësor mund të marrin 38% më shumë.

Gjithsesi, do ta shpjegoj më në detaje edhe atë se çfarë kemi bërë për legjislacionin në pikën e dytë të pyetjes.

Një tjetër zhvillim ka qenë bashkëpunimi ndërkombëtar që kemi pasur. Autoriteti vjet zhvilloi tre aktivitete shumë të rëndësishme dhe këtë vit ne do të kemi përsëri një aktivitet shumë të rëndësishëm në Shqipëri, konferencën vjetore për tregun e pensioneve dhe besoj se është konferenca më e madhe financiare që ka pasur Shqipëria, pas viti '91.

Kjo konferencë do të jetë në nëntor të këtij viti.

Arben Ahmetaj – Të lutem, na bëj ftesë!

Ervin Koçi – Patjetër do t'ju bëj ftesë.

Njëkohësisht kemi rritur shumë transparencën, e përmendi edhe zonja Dhima në relatin e saj, edhe në raport e keni. Ne jemi një institucion që vlerësohemi shumë për transparencën. Ne kemi sot raporte statistikore, pa modesti, ndër më të mirat që ka Europa Juglindore, bashkë me Poloninë, ndër të cilët kemi informacion të detajuar për çdo tregues dhe cildo, një vizitor i huaj, një qytetar mund të gjejë një informacion të bollshëm për të bërë investimet e duhura apo për të gjetur kompaninë ku dëshiron të investojë apo të sigurohet.

Njëkohësisht, një marrëdhënie shumë e rëndësishme është për zhvillimet teknologjike.

Zhvillimet teknologjike kanë qenë shumë të rëndësishme jo vetëm në Autoritet, por këtë e kemi pasur edhe me shoqëritë e sigurimeve dhe tashmë edhe me fondet e pensioneve dhe të kapitaleve.

Ne jemi të bindur se strategjia 5-vjeçare që e kemi bërë është e ardhmja dhe detyrimisht duhet të përshtatemi në mënyrë që nesër, me zhvillimet teknologjike, me dinamikën e tregjeve ne duhet të përshtatemi me zhvillimet teknologjike në mbrojtje të konsumatorit dhe të investitorit.

Tashmë ne jemi në fazën përfundimtare të disa projekteve të rëndësishme, të cilat besoj se i mbyllim për disa muaj. Këto projekte na bëjnë ne si Autoritet të kemi informacion të bollshëm online për disa muaj, për vete, për qytetarët, për publikun për çdo treg që ne mbikëqyrim.

Për sa i përket legjislacionit, ne kemi dorëzuar 4 projektligje, kemi bërë 20 rregullore dhe udhëzime të reja dhe rreth 11 ndryshime rregulloresh. Të gjitha këto kanë qenë në funksion të mbrojtjes së konsumatorit.

Dy ligje i kemi çuar vetëm muajin e kaluar dhe janë në konsultim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, që janë ligjet për tregjet e kapitaleve dhe fondet e investimeve. Këto janë ligje shumë të rëndësishme.

Ne jemi të bindur për ndryshimet që do të bëhen në këto 4 ligje. Jemi duke punuar me një grup pune ndërqeveritar, me Bankën Botërore dhe me SEIKO-n, sepse kemi fituar një

projekt të ri 2 milionë dollarë grant nga SEIKO për të përmirësuar aktet rregullative. Ne kemi një revolucion të vërtetë në legjislacion.

Ne duhet që bashkë me ju të përshpejtojmë miratimin e këtyre ligjeve, në mënyrë që këto të kthehen në benefite për tregun, konsumatorin dhe ekonominë e vendit.

Për sa i përket regjistrimit elektronik mund të them se ne e kemi këtë regjistër tashmë dhe jemi duke punuar për regjistrin elektronik të dëmeve. Besoj se mbaron brenda këtyre dy muajve dhe duhet theksuar se ky regjistër financohet përsëri nga kompanitë e sigurimit. Pra, çdo qytetar, nëse ka një dëm do ta shikojë online se si ecën procesi i trajtimit të dëmit deri në pagesë dhe nëse ka një afat kohor në Autoritet do të jepet sinjali dhe ne do të ndërhyjmë menjëherë.

Njëkohësisht, ne kemi regjistrin online të ankesave.

Arben Ahmetaj – Ju lutem, në lidhje me pyetjen që bëri zonja Mesi, kush do ta administrojë regjistrin e dëmeve?

Ervin Koçi – Faktikisht, regjistri elektronik në tërë botën administrohet nga byroja dhe shoqata. I vetmi që e administron regjistrin elektronik qysh nga viti 2007 është Autoriteti. Në projektligjin e ri që kemi sjellë për sigurimin e detyrueshëm mund të jetë objekt diskutimi, por tregu edhe pas takimit që kemi bërë me shoqatat (se kemi bërë korrespondencë me shoqatën që ta marrin ata përsipër) ende nuk jemi të gatshëm për ta marrë përsipër.

Arben Ahmetaj – Jam i qartë.

Ervin Koçi - Zonja Mesi, për sa i përket transparencës, unë besoj se në faqen tonë keni të gjithë informacionin që ju kërkoni për tregun dhe shoqëritë që operojnë në këto tregje. Ndërsa për të dhënat individuale është e pamundur, se Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk na lejon të japim të dhëna personale për individët.

(Diskutime pa mikrofon)

Për sa i përket Manivalit, ne kemi një komunikim dhe jemi vlerësuar njësoj me Bankën e Shqipërisë. Jemi të moderuar dhe jemi pa risk. Tregu i sigurimeve në Shqipëri, sidomos sigurimit të jetës dhe të pensioneve, është shumë i vogël dhe aktualisht nuk përbën risk.

Misioni i Manivalit ka lënë 4 rekomandime dhe i kemi realizuar të gjitha. Kemi bërë 3 inspektime bashkë me Drejtorinë e Parandalimit dhe të Pastrimit të Parave, kemi bërë inspektim të përbashkët me Bankën e Shqipërisë dhe disa inspektime vetë, ku kemi trajnuar 2-3 persona, të cilët merren me këtë fenomen.

Aktualisht ne kemi komunikuar përsëri me Drejtorinë e Parandalimit dhe të Pastrimit të Parave dhe u kemi kërkuar nëse mund të bëjmë diçka shtesë përtej rekomandimeve, në

mënyrë që raporti që do të dalë në muajin nëntor, të jetë një raport pozitiv, jo vetëm për Autoritetin, se ne jemi të sigurt që opinioni është pozitiv, por për gjithë raportin e Manival-it.

Për likuiditetin e tregut dhe të shoqërive mund të them se tregu në total mbulon 100% të provigjioneve. Dy kompani janë me probleme, për të cilat ne kemi marrë masat e duhura mbikëqyrëse dhe besoj se në fund të vitit do të mbyllet si proces.

Besoj se brenda vitit ne do të kemi një ndryshim radikal të të gjithë situatës.

(Diskutime pa mikrofon)

Senida Mesi – Është shumë i rëndësishëm ky diskutim dhe përgjigjja e drejtorit pasi në vitin 2017 pesë kompani nuk kanë plotësuar detyrimet ligjore për minimumin e kapitalit dhe përqindjen e detyruar me ligj për mbulimin e provigjioneve. Sot që flasim, për dy vjet janë përsëri dy kompani të identifikuara me një plan masash të përcaktuar me qëllim që deri në fund të vitit 2019 edhe këto dy kompani duhet të plotësojnë detyrimet ligjore, me qëllim që të kenë likuiditetin e mjaftueshëm për të operuar në tregun ku ata zhvillojnë aktivitetin. Kjo është një ecuri shumë pozitive që me të vërtetë duhet përgëzuar.

Arben Ahmetaj – Është e vërtetë ajo që thatë ju. Mua më tërhoqi vëmendjen pyetja juaj që kishte të bënte me mbrojtjen e konsumatorit. Besoj që në rezolutë do të duhet ta theksojmë si pikë më vete, ndërsa për sa i përket plotësimit të raporteve, unë kam punuar me kryetarin, me drejtorin dhe me Autoritetin në funksionin si ministër Financash dhe besoj se Autoriteti është jashtëzakonisht shumë dilixhent në lidhje me plotësimin e të gjitha detyrimeve ligjore, për sa u përket raporteve qoftë të kapitaleve, qoftë të provigjioneve. Besoj se deri në fund të vitit 2019 do të kemi një rezultante të raportuar goxha më të përmirësuar sesa ajo që kemi sot, megjithatë ajo që tha zonja Mesi duhet të ritheksohet se në 3-5 vjet këto raporte për shkak të punës suaj janë përmirësuar në mënyrë të ndjeshme.

Faleminderit!

Ka pyetje tjetër?

Po, zoti Ismet.

Ismet Beqiraj – Përshëndetje!

Është gjë e mirë kur dëgjon në këtë raportim edhe rezultate, edhe pse në një klimë jo të qetë politike të vitit të kaluar. Unë do të ndalem në disa pyetje. Cilat mund të jenë drejtimet dhe elementet ende të pashfrytëzuara për rritjen e peshës specifike të volumit të tregut të sigurimeve ndaj GDP-së, kur realizimi për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017 është 1,06%, pra ka ende të pashfrytëzuara?

Si e ka menduar institucioni juaj mbrojtjen e konsumatorëve dhe të biznesit në lidhje me dëmet dhe fatkeqësitë natyrore në sektorin e bujqësisë, si përmbytjet, thatësitat, duke

pasur parasysh edhe ndryshimet klimaterike që do të jenë ciklike dhe të vazhduara edhe nga infeksionet epidemike në frutikulturë dhe në bujqësi, sidomos në bimësinë e ullirit?

Për tregun e kapitaleve, cili është mendimi juaj në lidhje me mundësinë e krijimit të bursës, të tregut të tokës edhe në kuadër të krijimit të regjistrit kombëtar?

Në lidhje me tregun energjetik, edhe një vit më parë e kam bërë këtë pyetje, po e përsëris: a ka përmirësime, pasi ne vërejmë që në tregun energjetik të tregtimit të nënprodukteve të naftës çmimet janë jo relativisht, por më të larta se vendet e rajonit? Si mendoni, cila është arsyeja, për shkak të monopolit në treg?

Arben Ahmetaj - Më falni!

Zoti Beqiraj, nuk është Autoriteti në fjalë përgjegjës për konkurrencën.

Ju lutem! Ka rregulla në komision. Do t'u bëjmë pyetje që kanë të bëjnë me punën e tyre dhe jo me punën e çdokujt tjetër. Nëse do të bëni pyetje që nuk kanë të bëjnë me punën e AMF-së, do ta ndaloj kryetarin të përgjigjet. Mos bëni pyetje për naftën, për tregtimin e naftës tek AMF-ja! Dakord?

Ismet Beqiraj - Ju lutem! E para, zoti kryetar, nuk imponohet mendimi dhe pyetja.

Arben Ahmetaj - Procedura imponohet, pastaj mendimi është i lirë.

Ismet Beqiraj - Të lutem!

Arben Ahmetaj - Çfarë të bëj, të të heq fjalën që bën pyetje për naftën tek AMF-ja?

Ismet Beqiraj - Nuk ma heq dot fjalën, por nuk imponohet mendimi. Unë po i bëj pyetje zotit Koçi për mbrojtjen e konsumatorit. Në rregull, ai le ta deklarojë: "Nuk i përgjigjem kësaj pyetjeje, sepse nuk është në tagrin e këtij institucioni".

Arben Ahmetaj – Unë ndjek procedurën dhe kjo e fundit nuk e lejon të bëhen pyetje që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë, se po flas unë! A ka mundësi që deputetët të bëjnë pyetje, të cilat kanë të bëjnë me punën AMF-së?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ismet, a të mbaroj unë, që të mos bëjmë debat që nuk ka vlerë? Të bëjmë debat me vlerë, është institucion financiar jobankar. Është Autoriteti që monitoron institucionet financiare jobankare. A i mbaruat pyetjet tuaja?

Po, zoti Koçi.

Ervin Koçi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti deputet!

Për sa u përket potencialeve, të tregut të sigurimeve dhe të kapitaleve, ato janë të mëdha. Ju e përmendët edhe vetë që penetrimi është vetëm 1,06% në raport me GDP-në. Kjo mund të ketë disa hapësira për zhvillim. Së pari, ne kemi përgatitur disa angazhime me Shoqatën e Sigurimeve në mënyrë që ata të jenë të orientuar më shumë drejt produkteve vullnetare dhe për *microinsurance*, është shumë e rëndësishme për vende si Shqipëria që të krijojë produkte (kjo ka të bëjë edhe me pyetjen tuaj për sa i përket sektorit të bujqësisë). Kompanitë shqiptare, bashkë edhe me ekzekutivin, duhet të shikojnë mundësinë për të afruar produkte për qytetarët me të ardhura të ulëta.

Për tregun e sigurimeve ekziston shumë mundësia nëse ne do ta arrijmë së bashku me tregun, me të gjithë operatorët e tjerë të ofrojmë një edukim financiar të domosdoshëm që publiku të kuptojë pse është e rëndësishme të sigurohet shtëpia, jeta, një pronë apo një pasuri, e cila i shërben aktivitetit të përditshëm të familjes së tij?

Në strategjinë 5-vjeçare që e kemi miratuar vjet, e kemi të qartë, e kemi si objektiv që në fund të vitit 2022, tregu do të jetë më i konsoliduar dhe lider në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Për këtë duhet jo vetëm mbrojtja e konsumatorit, por duhet të kemi ligje të mira, qytetarë të ditur dhe besim në tregje. Këto janë 3 shtyllat në të cilat ne jemi mbështetur dhe nëse ne i shfrytëzojmë këto 3 shtylla, besojmë se do të kemi mundësi për zhvillimin e tregut të sigurimeve.

Te tregu i kapitaleve, u përmend në pyetjet më përpara bursa, ndryshimet ligjore që do të vijnë për tregun e kapitaleve, për fondin e investime dhe për pensionet private, janë elemente shumë të rëndësishme për zhvillimin e tregut të kapitaleve dhe janë një potencial i jashtëzakonshëm.

Për sa i përket pyetjes së dytë, për dëmet që mund të ketë sektori i bujqësisë, në muajt tetor- nëntor ne i dërguam një shkresë Ministrisë së Bujqësisë për merakun që keni, në mënyrë që kjo e fundit të financonte 5 milionë dollarë dhe 5 milionë dollarë nga qytetarët për të siguruar rreth 30 mijë fermerë që kishin serra. E dërgon propozimin konkret deri në limit përgjegjësie 5-10 mijë euro.

Arben Ahmetaj- Zoti drejtor, çfarë përmbante shkresa, që ju i kërkonit, kujt?

Ervin Koçi - I kërkonim Ministrisë së Bujqësisë të siguronte bujqit...

Arben Ahmetaj- Të siguronte ministria bujqit?

Ervin Koçi - Jo të siguronte ministria, por të kishte një projekt ku të financohej një produkt i përbashkët, bashkë me fermerët në mënyrë që të kishin mundësi për të siguruar...

Arben Ahmetaj - Më falni! Është e rëndësishme, por nuk e kuptova. Ju i keni kërkuar ministrisë që të financojë apo çfarë të bëjë?

Ervin Koçi - Të financojë bashkë me qytetarët.

Arben Ahmetaj - Ku ti gjejë ministria? Ju keni qenë edhe deputet i këtij komisioni. Të subvencionojmë tani edhe sigurimin e bujqësisë nga buxheti i shtetit? Ne sapo u hoqëm TVSH-në e imputeve, apo edhe ju jeni në logjikën e subvencionimit total?

Ervin Koçi - Ne këtë e përdorëm si praktikë, e morëm nga një vend, kishim një grup të përbashkët pune...

Arben Ahmetaj - Nga cili vend, se jam shumë i interesuar?

Ervin Koçi - Ne fituam një projekt *microinsurance*...

Arben Ahmetaj - Nga cili vend e morët këtë praktikë?

Ervin Koçi - Nga Kenia apo Kongoja, në një nga këto dy shtete.

Arben Ahmetaj - Faleminderit!

Ervin Koçi – Për sa i përket pyetjes për tregun e tokës, faktikisht bursa e tokës nuk ka lidhje me instrumentin financiar dhe nuk është titull, njëlloj si bursa e energjisë dhe është jashtë mbulimit të Autoritetit.

Pyetja e fundit që bëtë për sa u përket karburanteve, mbrojtjes së konsumatorëve, ne nuk e mbulojmë këtë si fushë, sepse më duket e janë dy institucione të tjera, të cilat merren me karburantet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Mbaruat apo jo?

Ervin Koçi – Po.

Mirë. Faleminderit!

Ka ndonjë pyetje tjetër? Unë desha të bëja një pyetje, por megjithatë u mbulua edhe në raport. Besoj se tregu i sigurimeve është ende shumë i ngushtë në Republikën e Shqipërisë, krahasuar me të gjitha vendet e rajonit. Edhe si përqindje e prodhimit të brendshëm bruto, është modest.

Besoj se një nga pikat kryesore të autoritetit do të jetë promovimi i konkurrencës në treg. Besoj se ju e dini më mirë se kushdo tjetër, kjo edhe për shkak të funksionit tuaj, se në dy elementë, për shembull, që janë: te TPL-të një, dhe dy te sigurimi shëndetit. Praktikisht, niveli i primeve një, dhe çmimi i primeve dy, janë modeste. Për shembull, te shëndetësia, që besoj se ju duhet të bëni një punë shumë të madhe, për një raport të kërkuar nga sistemi shëndetësor në 500 euro, primi është 100 euro.

Praktikisht, ky sistem nuk ka për të ecur, në qoftë se ju nuk do të merreni specifikisht me konkurrueshmërinë dhe raportin kosto të shërbimit me koston e primit. Përndryshe, do të

vijë një ditë që do të jetë false e gjitha. Pastaj, nëse biem dakord si komision, ky shqetësim duhet të shtohet edhe në rezolutë, edhe te TPL-të. Do të duhet patjetër.

Në këndvështrimin tim personal, por edhe si kryetar i komisionit, mendoj se ju si autoritet duhet të bëni pikësëpari një analizë të detajuar, sidomos me shëndetin. E dyta pastaj, për TPL-të, por në këndvështrimin tim, kjo e shëndetit është urgjente, ndaj do të duhet të merreni me të specifikisht. Faleminderit!

Ka ndonjë pyetje tjetër, ndonjë qëndrim tjetër? Një koment nga zoti Bushati. Ju lutem, zoti Bushati.

Ervin Bushati – Faleminderit!

Në radhë të parë mendoj se vendosja e një stabiliteti apo edhe e një konsolidimi makroekonomik dhe financiar, edhe një pjesë e mirë e punës së këtij komisioni, edhe qeverisja, edhe zgjedhja juaj, na kanë krijuar kushte që ne të shohim një hap përtej. Kemi krijuar bazat, që AMF-ja të mos jetë më zgjidhje problemesh, por të jetë një bazë e rritjes ekonomike dhe e investimit të mëtejshëm.

Premisa postkrizë, kur rritja ekonomike dhe inflacioni, të dyja bashkë, mjaftojnë që të jenë më të larta se sa norma e interesit, gjë që po shikohet në Shqipëri, mund të bëjë të ulët borxhi kombëtar, një në raport me GDP-në, si përqindje, dhe dy, të ndihmohet më shumë ekonomia. Kështu që, i kemi kushtet, pa i hyrë politikës, e një rrethi virtuoze, që quhet në ekonomi, ku normat e interesit janë të ulëta, siç e thatë edhe ju, rritja ekonomike është e lartë, deficitit buxhetor vjetor është gjysma e rritjes ekonomike. Pra, unë mendoj se kemi një raport shumë të mirë. Siç e thatë ju, kemi edhe një pjesë të madhe të depozitave në banka, duke e ditur se norma e interesit është shumë e ulët.

Pra, në këtë pikë, mendoj se, në radhë të parë, ka shumë mundësi që nëpërmjet reformave strukturore, që duhet të fillojnë të aplikohen tani, sa jemi në kohë të mirë, të fillojnë të nxiten investimet dhe kapitali shqiptar, që të hedhë më shumë në treg, si në parametra dhe kapitale financiare, ashtu edhe në investime direkte në ekonomi. Në lidhje me këtë, mendoj se koha për t'u bërë është sot. Ato reforma që nuk bëhen në kohë të mirë, bëhen në kohë të keqe, por me koston e taksapaguesve. Kjo është një histori, të cilën e kemi parë në Shqipëri, e ka treguar edhe ekonomia botërore. Për sa kohë i shtyjme reformat, nëse bëhen gjatë stuhisë, krijojnë kosto për taksapaguesit, gjë që ne duhet ta evitojmë. Kjo është e para.

Nëse keni ligje, reforma, propozime, duhet t'i sillni sa më shpejt në këtë komision. Ju sugjeroj dhe ju bëj thirrje, që për sa kohë kemi këtë avantazh, pra që kemi erën në favor, t'i sjellim sa më shpejt.

E dyta, të gjejmë format, të gjejmë mundësitë, të gjithë së bashku: qeveria, legjislativi, por edhe ju si mbikëqyrës, për t'i rritur sa më shumë investimet në treg.

Ju e thatë shumë mirë, që sot ka kapitale të pashfrytëzuara në treg. Pra, në qoftë se depozitat janë diku të 6 apo 7 miliardë euro, dhe në qoftë se gjysma e 7 miliardëve...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

8 miliardë, se qenka rritur akoma. Pra, në qoftë se 4 miliardë euro flenë në banka në Shqipëri, kanë një gjumë të sigurtë, se bankat janë të sigurta, por normat e interesit janë shumë të ulëta. Sot Banka e Shqipërisë është në një rekord normash të ulëta interesi. Nuk kanë qenë ndonjëherë kaq të ulëta kostot e interesit. Pra, paraja nuk vlerësohet më, që të flejë e qetë në banka, por duhet nxitur që të investohet s' amë shumë në treg. Ne mendojmë se i kemi krijuar këto kushte, nga pikëpamja makroekonomike, pra nuk kemi më një shtet që ndërhyr dhe blen borxhe në treg, duke rritur në mënyrë artificiale normën e interesit. Ne nuk marrim më borxhe nga bankat, se kemi dalë në tregje ndërkombëtare, madje me norma shumë mira interesi.

Pra, të gjitha këto para, të cilat sot janë në banka, patjetër që duhen nxitur. Mendoj se ne, si qeverisje, e kemi bërë punën tonë. Mund të bëjmë edhe më shumë ligje të mira, për t'i nxitur shqiptarët që të investojnë, por mendoj se këtu ka edhe një punë shumë të madhe për të bërë, si Banka e Shqipërisë, ashtu edhe autoriteti juaj. Ju thatë që jemi drejt shtyrjes dhe se po përpiqemi që bursa të bëhet sa më shpejt efektive e funksionale, gjë që patjetër do të jetë një katalizator apo motori për rritjen e investimeve në ekonominë shqiptare, por mendoj se duhet parë edhe përtej kësaj. Kemi një diskutim shumë të gjatë në lidhje me hapjen e bursës, që po shkon gati tri dekada, por mendoj se duhet finalizuar. Përtej saj, duhen parë edhe mënyra të tjera për të dalë në tregje.

Jam dakord edhe me sugjerimin e kryetarit, që sot shumë tregje mund të aksesoren edhe në mënyrë elektronike, si bursat në Europë e më tej. Pra, duhen parë mënyrat. Nëse duhet të presim vetëm për bursën fizikisht në Shqipëri, i humbasim vetes të drejtën. Pra, ne mund të jemi në një interes të ndryshëm. Ne duam të shikojmë s' amë shumë investime, ju patjetër duhet të mbani edhe stabilitetin, që këto investime të jenë sa më të rregullta, por duhen parë edhe mënyra të tjera, se si mund të investohet në tregje, të cilat sot janë të aksesueshme në mënyrë elektronike në të gjithë botën, sidomos tregjet e teknologjisë së re, që janë shumë të mundshme.

Këto janë dy pikat që doja të trajtoja. Duke ju uruar punë të mbarë, dua të theksoj edhe një herë se ligjet më të mira që keni sjellë, puna e qeverisjes në parametrat makroekonomikë, sidomos konsolidimi fiskal, që është bërë deri më sot nga Ministria e Financave, por edhe puna juaj shumë që mirë, dua të them, duhet të na bëjnë të shohim në këto dy drejtime që sapo parashtrova.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Bushati!

Ka ndonjë koment të fundit, përpara se të falënderojmë autoritetin?

Mirë atëherë, zoti Koçi, zoti Melani, ju faleminderit për raportimin!

Besoj se edhe në rezolutë është theksuar përmirësimi i punës monitoruese. Besoj se nga pyetjet e anëtarëve të komisionit dhe nga komentet tona, ju sigurisht që mund të theksoni edhe detyrat që do të duhet të përmbushni në të ardhmen. Draftrezoluta është e detajuar, është e qartë, dhe do t'i prezantohet Kuvendit të enjten nga ky komision për ta votuar dhe kaluar.

Faleminderit punë të mbarë!

Dy minuta pushim sa të vijë Këshilli i Statistikës, Financa dhe biznesi.

Kam një vërejtje për procedurën, votohet rezoluta. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 27.05.2019, ora 10.30

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me kandidatët për emërimin anëtar në Këshillin e Statistikave:

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Reme Lala, Antoneta Dhima, Evis Kushi, Ervin Bushati, Vullnet Sinaj, Senida Mesi, Ismet Beqiraj, Nikolin Staka, Ardit Konomi, Edlira Hyseni, Artemis Dralo (Malo) dhe Dritan Bici.

Mungojnë:

Anastas Angjeli dhe Blerina Gjylameti.

Të ftuar:

Eni Vasili – kandidate e propozuar nga Këshilli i Ministrave

Ines Mucostepa - kandidate e propozuar nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë

Endrit Lami - kandidate e propozuar nga Ministria e Financave

Arben Ahmetaj - Fillojmë me përfaqësuesin e Ministrisë së Financave. Endriti vjen si propozim i Ministrisë së Financave. Besoj se në eksperiencën time prej gati 27 vjetësh në administratë, Endriti është një nga punonjësit më të mirë që ka fatin të ketë administrata shqiptare. Kështu që unë për Endritin nuk kam asnjë pyetje dhe besoj se është propozim i duhur nga Ministria e Financave. Unë nuk dua që të kalojmë CV-në e Endritit. Gjej rastin ta falënderoj personalisht që kemi pasur një bashkëpunim ekselent bashkë. Ai është drejtori i makroekonomisë në Ministrinë e Financave. Nëse ka dikush pyetje për Endritin, mund t'ia bëjë, nëse jo, besoj se nuk kemi nevojë as ta diskutojmë.

A ka pyetje për Endritin?

(Ndërhyrje pa mikrofoni)

Nuk ka nevojë të prezantohet, sepse është prezantuar shumë herë me punën e tij.

Edlira Hyseni –Mos ndoshta ka dëshirë të prezantohet. Unë personalisht nuk ju njoh dhe me gjithë respektin për opinionin e kryetarit do të doja t'ju njihja.

Arben Ahmetaj – Endrit, keni kohë dy minuta për prezantim.

Endrit Lami-Unë quhem Endrit Lami. Aktualisht punoj si drejtor në Drejtorinë e Makroekonomisë në Ministrinë e Financave. Kam disa vite që punoj aty dhe merrem çdo ditë me statistika. Të tjerat janë të shkruara.

Arben Ahmetaj –Endrit, zonja deputete ju pyeti për arsimimin, ju lutem prezantoni!

Endrit Lami – Diplomimi im është në Universitetin Bujqësor të Tiranës, pastaj kam bërë edhe një master në Universitetin e Tiranës, dega Ekonomi.

Arben Ahmetaj –Faleminderit, Endrit!

Kush është pro me propozimin për Endritin? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kandidatura i propozohet seancës për Këshillin e Statistikave.

Faleminderit!

Vazhdojmë me zonjën Ines.

Ju lutem, një prezantim të shkurtër të CV-së suaj. Pastaj, nëse komisioni ka pyetje, mund t'ia bëjë.

Ines Muçostepa- Quhem Ines Muçostepa, kryetare e Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë. Kandidatura ime u propozua pikërisht nga ky institucion edhe për faktin se në bazë të ligjit të dhomave të tregtisë dhe industrisë institucioni ynë ka lidhje të drejtpërdrejtë me pjesën e statistikave. Ne jemi mbledhës të të dhënave të ndryshme lidhur me tregtinë apo çdo informacion që ka lidhje me ekonominë dhe përpunojmë edhe vetë statistika.

Në qoftë se do të flisja sot, përveç faktit ligjor, mund të themi se një nga sfidat e Bashkimit të Dhomave të Tregtisë është edhe promovimi i sipërmarrjes shqiptare brenda dhe jashtë vendit, duke qenë edhe pjesë e shumë institucioneve të rëndësishme të sipërmarrjes europiane apo asaj ballkanike.

Edhe unë jam përfaqësuese dhe anëtare e Parlamentit të Sipërmarrjes Europiane, jam edhe anëtare e bordit themelues të Chamber Investment Forum (Dhoma Ekonomike Rajonale), e cila prej 4 vjetësh po punon fort në procesin e Berlinit pikërisht për të sjell një zhvillim ekonomik në të gjithë rajonin.

Jam anëtare e ABC-së, shoqatës më të madhe ballkanike të dhomave dhe shoqatave të tregtisë. Në të gjitha këto institucione, flas për fushën ndërkombëtare, ne prekim çdo ditë pjesën e statistikave dhe numrave.

Ne jemi duke punuar fort me platformën e investimeve të eksporteve në promovimin e Shqipërisë, ku statistikat janë shumë të rëndësishme për ne, sepse jemi pjesë e dy projekteve shumë të rëndësishëm, duke përfshirë këtu edhe MAP REA, ku sipërmarrja jonë do të gjendet në një platformë, ku nga ana tjetër do të kemi BE-në. Pra, numrat te ne janë pjesë e punës.

Në qoftë se duhet të flas për veten time, dua t'ju them se unë kam mbaruar në Romë, fakultetin juridik të Sapienzës, ku baza është juridike. Si profesion jam avokate, të cilin e ushtroj në Itali dhe Shqipëri. Më është dashur të bëj trajnime lidhur në pjesën ekonomike. Nga viti 2009 e në vijim vazhdoj të jem administratore e një prej kompanive më të rëndësishme në Shqipëri, një nga kompanitë që paguan shumë kontribute në ekonominë shqiptare. Nëse duhet të them se ku qëndron roli, përdorimi i numrave apo statistikave, dua të përmend Komitetin Kombëtar të Lehtësimit të Tregtisë, ku unë jam anëtarë, Këshillin Mbikëqyrës të Bursës Shqiptare, bordin e AIDA-s, Këshillin Ekonomik të Bashkisë Tiranë, Këshillin Ekonomik Kombëtar e të tjerë.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Muçostepa!

A ka ndonjë pyetje për zonjën Muçostepa?

Ervin Bushati- Shqipëria ka avancuar dhe ju jeni dëshmitare e saj si në biznesin tuaj, ashtu edhe në funksionin që keni në Dhomën e Tregtisë. Shpeshherë, kur dalin shifrat nga INSTAT-i, gjithmonë fillon dhe bëhet predikimi emocional i të gjithëve që shifrat janë vetëm të INSTAT-it, ndërkohë ju thatë që merrni të dhëna dhe nxirrni të dhënat, sa shpesh i nxjerr dhe i publikon Dhoma e Tregtisë këto të dhëna, në mënyrë që të jenë në sinkron dhe të ndjehet që të dhënat zyrtare janë zyrtare, pastaj pjesa e rritjes ekonomike nuk lidhet më me anën emotive, që ne nuk po e ndiejmë, por që të fillojë të ndihet: sa shpesh i publikoni të dhënat? Sa

shpesh i mbron të dhënat para qytetarëve, që, kur thuhet është rritur 4%, është rritur kaq; kur thuhet bie inflacioni, bie. Sa shpesh i publikoni?

Në fund do të bëj edhe një koment të shkurtër.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Urdhëroni, zonja Muçostepa!

Ines Muçostepa – Edhe ne bazohemi te shifrat e INSTAT-it, si shifra zyrtare, të cilat publikohen në Shqipëri, ashtu si edhe në ekonomitë e vendeve ballkanike, ku të gjithë u referohen shifrave të INSTAT-it.

Ne përdornim të dhëna dhe herë pas here bënim statistika në mënyrë të limituar deri para pak vjetësh, sepse sistemi i dhomave të tregtisë ka pasur një dobësim të rëndësishëm në vitet e fundit. Në momentin kur kërkuam forcimin e dhomave të tregtisë, një nga pikat kryesore, për të cilën kemi lobuar fort, është se shpesh ne nuk arrijmë të realizojmë një nga misionet tona: atë të përgatitjes së statistikave. Kjo ndodh për shkak se shpesh kërkohen fonde të rëndësishme. Në periudhën e fundit jemi duke punuar kryesisht me fonde, të cilat kanë lidhje me projektet. Statistikat e fundit janë të përgatitura në një kuadër rajonal, ku edhe ne jemi bërë pjesë. Pra, kanë qenë platforma të GIZ-it ose të BERZH-it, me të cilët kemi punuar për t'i bërë këto statistika. Në qoftë se sot do t'i referoheshim sistemit të dhomave të tregtisë, mund të themi fare mirë që forca e tyre nuk është si më parë, sepse sistemi ka nevojë të forcohet.

Arben Ahmetaj – A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Urdhëroni, zoti Bushati, për komentin tuaj!

Ervin Bushati – Faleminderit!

Në fakt, Shqipëria ka bërë një ndarje...

Arben Ahmetaj - E keni koment për kandidaturën?!

Ervin Bushati – Po.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ligji që ndryshuam ne, në të mirë të dhomave të tregtisë, ishte që t'u jepnim më shumë kredibilitet dhe funksionim më të qartë. Ne presim dhe do të mirëpresim që, kur të dalin të dhënat, kur të publikohen, të ketë një mbështetje nga ju si dhoma tregtie dhe nga shumë institucione të tjera, që funksionojnë gati si shtetërore, pra se keni një lloj ligji dhe leje edhe nga shteti, por të jetë edhe si pjesë e lobimit të biznesit, pra të thuhet dhe të publikohen këto të dhëna dhe të mos i mbeten vetëm pjesës politike, siç quhet pa të drejtë INSTAT-i. Kur dalin ato, thuhet: “INSTAT-i është i juaji, nuk i besojmë këto shifra, sepse i keni promovuar ju, i keni fabrikuar ju”. Pra, unë, si ligjvënës, me të drejtë, do të prisja nga dhoma e tregtisë dhe nga të gjitha institucionet, të cilat me të drejtë kërkojnë ato që u takojnë me ligj, të gjitha lobimet,

të gjitha konfindustritë e të tjera, të cilat janë shumë dhe janë në garë, në fund të ditës të thonë: “Po, me sondazhet që ne bëjmë”. Ndoshta nuk do të merrni ndonjëherë para nga taksapaguesit e huaj për këtë punë, por ju keni kompani shumë të mira dhe funksionale dhe keni sondazhet tuaja. Mblidhni të gjitha këto dhe dilini e thoni që rritja është kaq dhe nuk diskutohet më ndërmjet PD-së, PS-së dhe LSI-së: “Jo, është rritja, por nuk e ndiejnë njerëzit apo rritja është e manipuluar”. Në fund, duhet që të gjitha institucionet që janë në Shqipëri, duke përfshirë edhe dhomën e tregtisë, që është shumë e besueshme, të dalin në mënyrë mujore, periodike të thonë: “Po, dalin këto të dhëna”.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Bushati për komentin tuaj!

Kush është dakord me kandidaturën e zonjës Ines Mucostepa për në Këshill? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit, zonja Muçostepa! Kandidatura juaj kalon për votim në seancë!

Zonja Eni Vasili, një prezantim të shkurtër 2-3 minuta. Besoj se puna juaj më shumë se 10 vjet si gazetare ekonomike dhe politike nuk ka nevojë të komentohet. Gjithsesi, një prezantim të shkurtër dhe, nëse ka pyetje nga anëtarët e komisionit, do të vazhdojmë.

Faleminderit!

Eni Vasili – Mirëdita të gjithëve!

Jam Eni Vasili, gazetare prej më shumë se 10 vjetësh, thuajse 20 vjet. E kam filluar në Radiotelevizionin Shqiptar në vitin '97. Ky ka qenë emërimi i parë, edhe pse angazhimi im në gazetari daton edhe më herët, më pas, si gazetare aty. Jam larguar nga RTSH-ja si kryeredaktore e lajmeve dhe moderatore e edicionit qendror. Më pas kam vazhduar në disa media të tjera si: drejtoreshë e informacionit, si autore e programit, të cilin kam edhe tani, që është një *brand*, i cili është në treg që nga viti 2005, në fillim si “Studio e hapur”, kurse sot si “Open”. Me këtë emër u transformua vitin e fundit, por është një emision, një format, i cili qëndron në treg prej 15 vjetësh, dhe është kryesisht një format politik, por, sigurisht ka target edhe tema të tjera, siç janë ato ekonomike apo sociale.

Kam mbaruar Fakultetin e Gjuhëve të Huaja. Kam bërë disa mastera: në Institutin e Studimeve Europiane të Tiranës dhe në Milano për ekonomi-biznes, komunikim politik dhe biznes, pra këto janë më kryesoret, sepse ka edhe shumë të tjera.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Edlira Hyseni – Përshëndetje!

Kam një pyetje të thjeshtë. Ne ju njohim dhe nuk besoj se asnjë nga ne kishte nevojë për prezantim të gjatë, por dua të di, përtej propozimit që ju bën Këshilli i Ministrave në këtë

funksion, ju vetë ku e ndieni dëshirën dhe interesin për të qenë pjesë e Këshillit të Statistikave? Si e mendoni kontributin që mund të jepni, apo ai Këshill mund t'ju shërbejë juve në punën tuaj? Dua ta kuptoj se si e shihni ju me syrin tuaj. Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Vasili!

Eni Vasili – Faleminderit për pyetjen!

Në rolin e gazetarit vlen të dëshmoj se nuk ka asgjë më të rëndësishme se statistikat për të ngritur çdo temë apo argument, qoftë politik apo edhe në çdo sektori tjetër. Nëse ka një gjë, për të cilën ne gazetarët vuajmë gjithmonë, janë pikërisht këto statistika të besueshme, mbi të cilat mund të ngremë argumente, ose të kuptojmë nëse në ndonjë studio, ose diku tjetër dikush na jep një argument të gabuar, të kemi statistikat e duhura. Kjo ka qenë arsyeja kryesore. M'u duk shumë interesant ky propozim për të kuptuar se si funksionon nga brenda. Ju e përmendët pak më parë, se ankohe mi gjithmonë nëse janë të vërteta apo jo këto shifra që prodhon ky institucion apo edhe institucione të tjera. Duke qenë brenda dhe afër mënyrës se si mund të prodhohet ky produkt kaq i rëndësishëm, siç është statistika, do të më ndihmonte mua si gazetar, por nëpërmjet meje edhe medien në përgjithësi, që të dyja palët të kenë më tepër akses në kuptimin se si funksionon pikërisht prodhimi i këtij produkti të rëndësishëm.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera për zonjën Vasili? Nuk ka.

Faleminderit, zonja Vasili!

Unë shpresoj që ato, që thatë ju për përdorimin e statistikës nga gazetarët, të kthehen në realitet, sepse vijmë nëpër studio, themi statistika... Kështu që, fatmirësisht, Këshilli i Ministrave ka bërë një propozim shumë të zgjuar, që ka futur një gazetarë prestigjioze dhe një anëtare të denjë të komunitetit të medias. Kështu, shpresoj që nga sot e tutje kur gazetarët të thonë: "Lërin statistikat, sepse statistikat nuk kanë rëndësi, se ju i bëni vetë" ju të vini në *Twitter*, në *Facebook* dhe në *Instagram* të filloni dhe të referoni që statistikat janë shifra, janë kokëforta dhe bie që të përputhem në fjalë me njëri-tjetrin.

Kush është dakord me kandidaturën e zonjës Vasili? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit, zonja Vasili! Kandidatura juaj i kalon për votim seancës plenare!

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar

Përgjegjësj e Sektorit të Redaktorëve

Anastas Angjeli

Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti